



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:099379

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05651486

K.DH.SH.II.nr.691/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Smartivo LLC SHPK NRB 810842957 me seli ne rr. Hajdar Dushi hyrja 9, nr.6 ne Prishtine te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi avokatë, ndaj debitorit BK Construction SHPK me NRB. 810746589 me seli rr Zhuj Selmani ne Pejë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.936/23, të datës 29.11.2023, me datën 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Smartivo LLC SHPK NRB 810842957 me seli ne rr. Hajdar Dushi hyrja 9, nr.6 ne Prishtine, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.936/23, të datës 29.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.190/23 të datës 31.05.2023, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat dhe përfundohet ne tersi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, të nxjerr aktvendim me të cilin aprovohet në tërësi ankesa e ushtruar nga kreditori, si e bazuar, të ndryshohet vendimi i ankimuar dhe te refuzohet ne tersi prapësim i debitorit dhe të lejohet përmbartimi sipas urdhrin përmbartimor, si dhe te paguhen shpenzimet e procedurës ne shume prej 104€.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të faturave të llastuara në urdhrin përmbartimor dhe aktvendimin e ankimuar. Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor i ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga fatura t'i paguaj shumën 882€, me kamat 8%, si dhe shpenzimet procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin ka kundërshtuar urdhrin për përmbartim dhe i propozon gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk përmban nënshkrimin e debitorit dhe vulën e pranimit dhe protokollimit të debitorit si institucion publik.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila fatura nuk kanë qenë e nënshkruar nga pranuesi i faturës, e që në këtë rast nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Neni 29 par.1 nënpar.1.1 përcakton se: “ 1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1 kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”. Në këtë rast e rëndësishme është që të vërtetohet se a është pranuar fatura nga ana e debitorit, pra e njëjta a është nënshkruar sepse kjo nënkupton se debitori i ka pranuar detyrimet e tij që i ka ndaj kreditorit.

Gjykata e Shkallës së Dytë, vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Shkallës së Dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i

rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga Gjykata e Shkallës së Parë është i drejtë dhe i bazuar. Andaj, fatura si dokument në saje të së cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori dhe nuk e ka vulën e pranimit të shkresave nga debitori në mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm, ndërsa vlerëson se me të drejt Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarimor që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.691/24, me datë 02.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi